



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_972\_06\_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 25.07.2013.

**në seancën e mbajtur më datë 06 shtator 2013, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit N.G. (shifra e konsumatorit: DPR - 1123) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_972\_06\_13 i datës 19.06.2013.

**Arsyetim**

Parashtruesi i ankesës ka bërë kërkesë në KEK me datë 26.08.2002 për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike, konsumatori në këtë kërkesë ka kundërshtuar borxhin e energjisë elektrike në vlerë prej 1,016€ të krijuar deri në periudhën e muajit 07/2002 si rezultat i mospagimit të borxhit të energjisë elektrike nga konsumatori A.N. ku i njëjti i është referuar aktvendimit Nr. 001123 të datës 21.08.2002 në emër të A.N.. Konsumatori në këtë kërkesë ka theksuar se nuk ka mundësi të bëjë pagesën e këtij borxhi pasi që ka një gjendje jo të mirë ekonomike dhe se me të ardhurat që ka mujore nuk mund t'ia dal pagesës së këtij borxhi, konsumatori njëkohësisht ka kërkuar nga KEK-u që të bëjë shlyerjen e këtij borxhi të energjisë elektrike.

KEK-u me datë 04.01.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke i theksuar se KEK-u se edhe përkundër gjendjes së rëndë shëndetësore si pasoj e luftës nuk ka mundësi të bëjë shlyerjen e obligimeve të konsumatorëve e në këtë drejtim as falje të kërkesave të KEK-ut, si dhe i është dhënë mundësia të provoj t'i drejtohet PURK-it gjegjësisht Rregullativit të Direktivës Administrative të UNMIK-ut.

Me datë 04.04.2001 është bërë nënshkrimi i kontratës për shitblerjen e banesës ndërmjet shitësit A.N. nga Prishtina në njërën anë dhe blerëses M.G. nga fshati Kryshevc KK Skenderaj në anën tjetër, dhe se kontrata e nënshkruar është vërtetuar edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 13.04.2001.

Prapë me datë 31.02.2008 2008 konsumatori N.G. ka parashtruar ankesë në KEK me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të mos shkyçet nga borxhi i energjisë elektrike për vlerën prej mbi 1000€ i krijuar prej periudhës prej para luftës i cili borxh është faturuar si lexim jo i rregullt, si dhe me datë



06.02.2009 ka kërkuar nga KEK-u shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike me arsyetimin se është përfitues i kategorive të rasteve sociale. Departamenti për konsumator në KEK me datë 13.02.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar pjesërisht ankesën e tij dhe ka konstatuar se duke marr për bazë kërkesën e konsumatorit për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike për faturat për njoftim për shkyçje dhe kyçje, gjithashtu rrjedhën e pagesave si dhe aplikimin e faturave për shërbim - njoftim për shkyçje dhe kyçje.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 19.06.2013 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 25.07.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_972\_06\_13 të datës 19.06.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nuk pajtohet me vendimin e DMK-së pasi që ankesa e tij është shqyrtuar parciaisht. Konsumatori thekson se viteve të fundit pothuajse çdo janar, shkurt fatura mujore i ka ardhur në vlerë prej 130 – 150 €, për të cilat nuk kam pajisje për t'i shpenzuar. Po ashtu konsumatori në ankesë ka theksuar se nuk është përmendur marrëveshja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me KEK-un që familjeve me gjendje të rëndë sociale t'i paguhet 500 kWh/muaj e që sipas konsumatorit KEK-u nuk bënë tarifim të drejtë.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me datë 06.09.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive të shifrës DPR - 1123 dhe ka vërejtur se kjo pikë matëse nga periudha 11/1999 e deri në periudhën kohore 11/2002 ka bërë shpenzim të energjisë elektrike në vlerë prej 1,015.55€ dhe se ky borxh ka ardhur si rezultat i mos pagesave të faturave mujore të energjisë elektrike. Nga kjo periudhë e deri në periudhën 02/2009 shihet se konsumatori nuk ka bërë asnjë pagesë të energjisë elektrike të shpenzuar sipas muajve, për atë edhe është ngarkuar edhe taksa për njoftim për shkyçje dhe me shkyçje. Ndërsa nga periudha 03/2009 e tutje shihet se konsumatori ka bërë pagesa të energjisë elektrike sipas muajve vijues.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe kontratën e shitblerjes së lidhur me datë 04.04.2001 në mes të shitësit A.N. dhe blerësit M.G., dhe konstaton se sipas kësaj kontrate nga kjo periudhë kohore është bërë pronar i ligjshëm i kësaj banese. Bordi i ZRRE-së po ashtu thekson se konsumatori në momentin e evitimit të këtij borxhi është dashur që t'i marr veprimet ligjore në përputhje me kontratën e shitblerjes dhe të kërkojë që borxhin kontestues ta paguaj shitësi e jo të kërkojë nga KEK-u, shlyerjen e një borxhi të tillë pasi që në këtë rast KEK-u ka qenë i dëmtuar pasi që ka bërë furnizimin e kësaj pike matëse me energji elektrike. Gjithashtu edhe KEK për borxhin kontestues të theksuar me lartë ka qenë i obliguar të kërkojë në përputhje me rregullat në fuqi. Sa i përket çështjes së borxhit të energjisë elektrike të krijuar para periudhës së blerjes së banesës nga konsumatori A.N. të datës 04.04.2001, Bordi i ZRRE-së thekson se mbështetur në nenin 29, paragrafi 1 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë nuk ka mandat të bëjë shqyrtimin e kësaj pjese të borxhit, pasi që sipas këtij neni theksohet se: "Çdo furnizues që vepron në kohën e nxjerrjes së kësaj rregulle, për ankesat dhe kontestet para vitit 2004, pavarësisht nga lloji i ankesës ose kontestit, do të drejtojnë konsumatorët e tyre për të filluar një procedurë gjyqësore kundër çdo vendimi të marrë prej furnizuesi".

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pjesën edhe pas periudhës së kontratës së shitblerjes, ngarkesat e taksave për njoftimet për shkyçje dhe taksave për shkyçje, dhe ka vërejtur se për periudhën kohore kur është ngarkuar konsumatori me këto taksa, konsumatori nuk ka bërë asnjë pagesë të energjisë elektrike edhe përkundër borxhit të krijuar nga shitësi i banesës, i njëjti ka vazhduar të krijoj edhe borxhe shtesë ndaj KEK-ut duke rritur edhe më shumë vlerën financiare ndaj furnizuesit. Sipas



transaksioneve të konsumatorit vërehet se njoftimet për shkyçje konsumatorit i kanë arritur me datë: 03.12.2005, 01.05.2006, 09.10.2006, 05.03.2007, 01.11.2007, 07.07.2008 dhe se shkyçjet konsumatorit i kanë ndodhur me datë 07.01.2005, 21.01.2006, 27.06.2006, 09.07.2007, 11.01.2008. Duhet theksuar se kur njoftimi i parë për shkyçje i ka shkuar konsumatorit me datë 03.12.2005 borxhi i energjisë elektrike ka qenë 2464.61€, që është borxh i krijuar edhe pas kontestit të cilën e ka cek konsumatori në ankesën e tij prej 1,015.55€.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës N.G., në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.09.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_972\_06\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar